

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ I UROŠEVAC **NË EMËR TË POPULLIT**

Më
Data

11-10-2018

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm

Divizioni Penal, si gjykatë e shkallës së parë penale, në përbërje nga gjyqtarja, Hakile Ilazi me procesëmbajtësja Ganimete Avdiu, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale kanosja nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.682-1/18 të dt. 03.04.2018, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me dt.16.05.2018 në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit-Mimoza Syla, të pandehurit dhe të dëmtuarit [REDAKTUAR], të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

AKT GJYKIM

I pandehuri; [REDAKTUAR] nga Shtimja rr. '[REDAKTUAR]', i lindur më [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR] babë i një fëmiju, ka të kryer fakultetin e Shkencave Politike, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I. Sepse më datën 10.02.2018, rreth orës 11:57, në fshatin [REDAKTUAR] Shtime, për shkak të mosmarrëveshjeve të mëhershme në mes të pandehurit dhe dëmtuarit [REDAKTUAR] pasi që vajza e të dëmtuarit ishte nda nga i pandehuri, përmes telefonit me numër [REDAKTUAR] me qëllim të frikësimit e ka kanosur seriozisht dëmtuarin, duke i dërguar SMS në telefonin e tij numër [REDAKTUAR] ku i ka shkruar "o jaran ti po mendon kaniher që ka marr fund kjo punë, ajo qika jote me gjithë at grun tane keni me u penduar për rahatin që ma keni shkaktuar në familje, kurr smerr fun kjo pun, as gjin mos u lodh me qu ma, [REDAKTUAR] jam djali i [REDAKTUAR] se sedi apo me nje " me ç'rast të dëmtuarit, i ka shkaktuar ndjenjën e shqetësimit, ankthit dhe të pasigurisë.

II. Më datë 01.03.2018, rreth orës 11:57, në fshatin [REDAKTUAR] Shtime, për shkak të mosmarrëveshjeve të mëhershme në mes të pandehurit dhe dëmtuarit [REDAKTUAR], pasi që vajza e të dëmtuarit ishte nda nga i pandehuri, përmes telefonit me numër [REDAKTUAR], me qëllim të frikësimit e ka kanosur seriozisht dëmtuarin, duke i dërguar SMS në telefonin e tij numër [REDAKTUAR] ku i ka shkruar "o boss funi ka ardh ja ktheje një martës për problemet që mi keni shkaktuar në familje 1 muj ki afat me kthyni martës ndryshe e kalon mujin ta jap besën ja mytym ja ta jap besën per hunë kam me jav nxjerr, mane men qita qka pju tham, ki pshtue herën e par let se qitash s'tke pshtu let ndesh shko n'polici, ndesh ku t'dush ti shko, ka ardhë fundi një martës me kthyni afat një muaj i ki, [REDAKTUAR] jam", me ç'rast të dëmtuarit, i ka shkaktuar ndjenjën e shqetësimit, ankthit dhe të pasigurisë.

Me të cilën ka kryer veprën penale në vazhdim kanosja nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitës së lartë përmendur dhe nen. 4,7,21,41,42,45 dhe 73 të KPRK-së si dhe nen. 365 të KPPK-së të pandehurin e:

G J Y K O N

Me DËNIM BURGIMI në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë aktgjykimit.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] komuna e Shtimes, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor në shumën prej 25 euro, si dhe shumën prej tridhjetë (30) € për programin për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

lidhur me par.1 të KPRK-së të kryer në vendin, kohën, mënyrën dhe rrethanat e përshkruara si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK-së, si rrethanë lehtësuese mori pranimin e fajësisë në seancën e shqyrtimit fillestar, pendimin e tij për veprën penale të shkaktuar, baba i në fëmiju, përkatësisht mbajtës i familjes, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh rrezikshmërinë konkrete të kryerjes së veprës penale, konkretisht këmbëngulësinë e kryerësit, duke kanosur vazhdimisht të dëmtuarin. Edhe pse në aspektin e kualifikimit ligjor kemi të bëjmë me një vepër penale, nga shkresat e lëndës por edhe nga aktakuza rezulton se i pandehuri ka kanosur më shumë se një herë të dëmtuarin. Për më tepër për të njëjtin është duke u zhvilluar edhe një procedurë penale në raport me të njëjtin të dëmtuar, e që të pandehurit me aktvendimin e kësaj gjykate PPR.nr.258/18, i është caktuar masa e paraburgimit.

Bazuar në këto argumente, gjykata është e bindur se dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj për të pandehurin është proporcional me peshën, rrezikshmërinë konkrete, karakteristikat e kësaj vepre penale dhe personalitetin e kryerësit dhe se me këtë dënim arrihet qëllimi i dënimit sidomos në kuptim të preventives speciale por asaj gjenerale.

Konform nenit 463 par.2 të KPPK-së, i dëmtuari [REDAKTUAR] për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.


Në bazë të nenit 450 dhe 451 të KPP-së, gjykata të pandehurin e obligoi që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 25 € (njëzetë e pesë euro), dhe konform nenit 39 par.3 pika 3.1 të ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimivae të Krimit, taksën në shumë prej tridhjetë (30) €, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin të përmbarimit me dhunë.

Nga arsyet e lartë përmendura është vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal,
P.nr.495/18, me dt.16.05.2018

Zyrtarja Ligjore,
Ganimete Avdiu

Gjyqtarja,
Hakile Ilazi



KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, për mes të kësaj gjykate.